

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Politikë Tarifore për Deponimin e Mbeturinave

Dhjetor 2007

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Misioni

“Ofrimi i shërbimeve kualitative, efikase dhe të qëndrueshme, të gjithë konsumatorëve në Kosovë nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta.”

Vizioni

“Rregullimi i sektorëve të ujit dhe mbeturinave të ngurta me anë të metodave transparente dhe të drejta në pajtim me praktikën e mirë europiane e cila garanton sigurimin e shërbimeve kualitative, të qëndrueshme, të pranueshme dhe të sigurta nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta kudo në Kosovë, duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik.”

Politikë Tarifore për Deponimin e Mbeturinave

Përmbajtje

| | | |
|-----------|---|--------------------------------------|
| 1. | HYRJE | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 1.1 | DISPOZITAT E VENDOSJES SË TARIFAVE TË RREGULLORËS SË ZRRUM-IT (RREGULLORE E UNMIK –UT NR. 2004/49)..... | 1 |
| 1.2 | OBJEKTIVAT | 1 |
| 2. | JURISDIKSIONI | 2 |
| 2.1 | KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË (KLMC) | 2 |
| 3. | OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. | |
| 3.1 | STRUKTURAT E TARIFAVE..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 3.1.1 | <i>Uniformiteti i tarifave</i> | 2 |
| 3.1.2 | <i>Karakteristikat e mbeturinave</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.2 | FAKTORËT MJEDISOR..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 3.2.1 | <i>Menaxhimi i prodhimit të mbeturinave</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.2.2 | <i>Taksat e zhvillimit dhe depozitimi</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3 | MBULIMI I KOSTOS..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 3.3.1 | <i>Përkufizimi</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3.2 | <i>Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3.3 | <i>Pritjet e eficiencës</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3.4 | <i>Mbulimi i kostove kapitale të investimeve</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3.5 | <i>Grantet dhe asetet e dhuruara</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4 | STRUKTURA E KAPITALIT, VLERA DHE KTHIMI ... | 6ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 3.4.1 | <i>Struktura e kapitalit</i> | 6Error! Bookmark not defined. |
| 3.4.2 | <i>Vlera rregullatore e kapitalit</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4.3 | <i>Kapitali i punës</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4.4 | <i>Kthimi i kapitalit</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4.5 | <i>Procesi i vënies së taksave</i> | Error! Bookmark not defined. |
| 4. | PROCESI | 8 |
| 4.1 | SHQYRTIMET KRYESORE TË TARIFAVE | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 4.2 | SHQYRTIMET E PËRKOHSHME | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |

1. HYRJE

1.1 Dispozitat e vendosjes së tarifave të Rregullorës së ZRRUM-it (Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2004/49)

Kjo politikë e lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) paraqet interpretimin dhe elaborimin e obligimeve ligjore lidhur me tarifat e deponimit të mbeturinave.

Veçanërisht, sipas Nenit 38 të Rregullorës së ZRRUM-it (*Rregullat e lëshuara nga Rregullatori*) kërkohet që ZRRUM-i të krijojë rregulla për vendosjen dhe aprovimin e tarifave. Kjo politikë është bazë mbi të cilën vendosen rregullat e tilla të detajizuara.

Neni 10 i Rregullorës së ZRRUM-it përshkruan obligimet e caktuara të vënies së tarifave duke përfshirë:

- Procesin e konsultimit (10.2)
- Pritjet e efektshmërisë (10.3 b), dhe
- Mjaftueshmërinë në përmbushjen e shpenzimeve kapitale (10.3 d)

Obligimet ligjore, siç është paraparë në Rregulloren e ZRRUM-it, lejojnë një shkallë të diskrecionit rregullativ të bazuar në gjykimin profesional, kuptimin e entiteteve rregullative (dhe rrethanave specifike të tyre) dhe kriterin socio-ekonomik.

Si vazhdim të procesit inicial të konsultimit, në Maj 2007 dhe pikëpamjeve pasuese të palëve tjera është përfunduar kjo pasqyrë e politikave siç është përcaktuar më poshtë.

1.2 Objektivat

Interesat e palëve të ndryshme nuk përputhen domosdo; për shembull interesat e konsumatorit për çmimet e ulëta janë kontradiktore me interesat e investitorëve në qëndrueshmërinë financiare. Është detyrë e ZRRUM-it të sigurojë që çmimet të japin një balancim optimal në mes të këtyre interesave dhe vlerë më të mirë të mundshme duke përfshirë çmimin dhe kualitetin e përmirësuar të shërbimit për shoqërinë. Kjo politikë tarifore është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë balancimin më të mirë të përgjithshëm.

2. JURISDIKSIONI

2.1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë(KLMC)

Ky dokument i politikave është bazuar në mjedisin institucional ku KLMC është i vetmi i ofrues i licencuar i shërbimeve të deponimit të mbeturinave. Megjithëse, janë disa ofruesë të palicencuar të shërbimeve të deponimit të mbeturinave që operojnë në Kosovë, parashikohet që ata do të mirren nga KLMC-a dhe të kenë funksion të njëjtë sikur aktivitetet e licencuara. Mandati i ZRRUM-it zbaton vetëm aktivitetet e kompanive të licencuara (KLMC) të deponimit të mbeturinave, kështu që kjo politikë është e kufizuar vetëm në aktivitetet e KLMC-së. Është e ditur që korniza institucionale për mbeturina (grumbullimi dhe deponimi) është duke u shqyrtuar dhe çfarëdo ndryshime lidhur me këtë çështje mund të shpiejnë në ndryshime të politikës tarifore.

WDPS 1: Jurisdiksioni

Kjo politikë tarifore zbatohet vetëm te aktivitetet e KLMC-së dhe nuk zbatohet te aktivitetet e ofruesve të palicencuar të shërbimeve.

3. OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE

3.1 Strukturat e tarifave

3.1.1 *Uniformiteti i tarifave*

Dihet se shpenzimet e deponimit të mbeturinave mund të dallojnë nga vendi në vend për shkak të shfrytëzimit të resurseve të disponueshme, ekonomive të shkallëve dhe faktorëve tjerë. Edhe pse efektshmëria ekonomike sugjeron që çdo ndërmarrje duhet të ketë tarifa që reflektojnë shpenzimet e tyre, ZRRUM-i mendon që qasja e tillë është e papërshtatshme në këtë fazë duke u bazuar në faktorët social dhe praktikitetin e raportimit financiar për ndërmarrjet e veçanta. Më shumë, ZRRUM-i duhet t'i shqyrtojë mundësitë për mekanizmat më të efektshëm ekonomik të tarifave që reflektojnë shpenzimet.

WDPS 2: Uniformiteti i tarifave

Gjatë periudhës afatmesme dhe periudhës afatgjate, tarifat duhet të jenë uniforme në të gjitha zonat e shërbimit të KLMC-së. Sidoqoftë, ZRRUM-i duhet të lë të hapur mundësinë që tarifat, në të ardhmën të vendosen në bazë rastësore kur sistemet raportuese janë mjaft të qëndrueshme të ndihmojnë analizën e shpenzimeve dhe të të hyrave të përcaktuara në bazë të njësisë operative (deponia individuale).

3.1.2 Karakteristikat e mbeturinave

Llojet e ndryshme të mbeturinave mund të kërkojnë trajtime më të veçanta, siç p.sh. janë produktet elektronike/elektrike, frigoriferët që përmbajnë CFC, etj. Prandaj, këtu kemi të bëjmë me tarifat e ndryshme për deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave. Mirëpo, aktivitetet e KLMC-së kryesisht nuk e bëjnë ndarjen e llojeve të ndryshme të mbeturinave edhe nëse e bëjnë, nuk ka struktura financiare që t'i identifikojnë ndryshimet në kostot. Prandaj, do të ishte e përshtatshme të mos mirret parasysh koncepti që tarifat t'i reflektojnë llojet e ndryshme të mbeturinave derisa nuk përdoren teknikat e ndryshme të deponimit dhe derisa zhvillohen sistemet e menaxhimit financiar të KLMC-së për të identifikuar diferencat në kostot.

WDPS 3: Karakteristikat e mbeturinave

Tarifat e deponimit të mbeturinave duhet të jenë uniforme pavarësisht nga lloji i mbeturinave të deponuara vetëm nëse deri në atë kohë nuk vendosen teknikat e ndryshme speciale të deponimit dhe nëse kostot e tyre janë të identifikueshme.

3.2 Faktorët mjedisor

3.2.1 Menaxhimi i prodhimit të mbeturinave

Shumë vende i kanë "taksat e deponimit" si mënyrën e reduktimit të prodhimit të mbeturinave dhe inkurajimit të riciklimit. Aktualisht, Kosova nuk ia imponon taksat e deponimit KLMC-së apo konsumatorëve të licencuar dhe si pasojë e kësaj nuk ka ndikim në tarifa. Megjithatë, ZRRUM-i e përkrah këtë koncept për taksat e deponimit dhe nëse qeveria vendos të imponojë taksa të tilla në të ardhmën atëherë shpenzimet duhet të kalojnë në tarifa të shërbimit të deponimit të mbeturinave.

WDPS 4: Taksat e deponive

Nëse përdoren taksat e deponimit atëherë shpenzimet duhet të reflektohen në tarifatat e deponimit të mbeturinave.

3.2.2 Taksat e zhvillimit dhe depozitimi

Menaxhimi i deponive përfshinë obligimin për rivendosjen e deponive në pajtim me standardet e mjedisit në fund të jetëgjatësisë së tyre. Për të siguruar që kompania nuk është duke i përmbushur obligimet për rivendosjen e deponive, qeveria mund të kërkojë nga kompania e deponive të bëjë depozitimin në kesh ose ta bëjë me anë të garantuesit kur të bëhet rivendosja e deponisë, vlera e së cilës është mjaft e lartë që të stimulojë operatorin për t'i përmbushur obligimet e tija. Me përmbushjen e obligimeve të tija, depozita i kthehet operatorit. Ndikimi në çmimet është kostoja oportune e kapitalit që kërkohet për të siguruar depozitimin e tillë të cilin operatori duhet ta mbulojë gjatë kryerjes së pagesave të tija.

Sidoqoftë, sipas strukturës së KLMC-së, qeveria është duke u larguar në mënyrë efektive nga rreziku dhe nuk do të kërkohet depozitimi i tillë apo garantuesi vetëm në rast nëse qeveria heq dorë nga ky aktivitet.

WDPS 5: Taksat e zhvillimit dhe depozitimi

Sipas strukturës aktuale së KLMC-së, qeveria në mënyrë efektive është duke u larguar rrezikun dhe depozitimi nuk është i nevojshëm. Mirëpo, nëse qeveria heq dorë nga ky aktivitet atëherë depozitimi duhet të kërkohet me qëllim që të mbrojë mjedisin nga dështimi që ta bëjë rivendosjen e deponisë në fund të jetëgjatësisë së saj. Kostoja oportune e depozitimit të tillë ose garantuesit duhet të reflektohet në tarifatat e shërbimeve.

3.3 Mbulimi i kostos

3.3.1 Përkufizim

WDPS 6: Përkufizimi i mbulimit të kostos

Gjatë periudhës afateshkurte të mbulimit të plotë të kostos duhet të përcaktohet nëse të hyrat janë të mjaftueshme për KLMC-në që t'i financojnë aktivitetet e tyre mbi bazën e rrjedhjes së parasë por në periudhën afatmesme, tarifrat duhet të përcaktohen mbi bazën e teknikave të kontabilitetit duke përfshirë provizionet për kthimin në kapital.

3.3.2 Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos

WDPS 7: Afati kohor për arritjen e mbulimit të plotë të kostos

Mbulimi i kostos duhet të jetë një qëllim afatmesëm, (brenda 5 viteve). Si minimum, të hyrat duhet t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet direkte operative dhe shpenzimet të mirëmbajtjes së kapitalit që është e nevojshme për të qëndruar në pajtim me obligimet e shërbimit dhe të mjedisit.

3.3.3 Pritjet e efijencës

Tarifrat duhet t'i pasqyrojnë pritjet reale të efijencës së përmirësuar nga KLMC-a e cila mund të realizohet me përfshirjen e sektorit privat dhe praktikave të përmirësuar brenda KLMC-së. Pritjet duhet të përcaktohen nga ZRRUM-i në konsultim me KLMC-në, AKM-në (ose institucioni tjetër pauses) dhe Bordi Mbikëqyrës/Drejtues i KLMC-së.

WDPS 8: Pritjet e përmirësimit të efijencës

ZRRUM-i duhet të përcaktojë pritjet reale të përmirësimit të efijencës në konsultim me KLMC, AKM (ose institucionin tjetër pauses) dhe Bordin Mbikëqyrës/Drejtues të KLMC. Caqet duhet të përfshihen në tarifa për shërbimet.

3.3.4 Mbulimi i kostove kapitale të investimeve

Investimet kapitale mbulohen përmes amortizimit por duhet të lidhet vetëm me investimet e bëra nga KLMC-a (WDPS 10: Trajtimi i granteve dhe aseteve të dhuruara). Provizionet e tilla mund të kalojnë përmes bazës së plotë vjetore ose përmes metodologjisë së llogaritjes për periudhë më të gjatë që siguron amortizimin që ka të bëjë me tonazhet e mbeturinave të deponuara.

WDPS 9: Mbulimi i kostove kapitale të investimit

ZRRUM-i mund të vendos që t'i përcjell shpenzimet e investimeve kapitale ose përmes provizioneve aktuale të amortizimit të shpenzimeve ose përmes modelit i cili varet nga ajo nëse procesi i mbulimit të kostos është afatgjatë apo afatshkurtë.

3.3.5 Grantet dhe asetet e dhuruara

KLMC-a nuk duhet t'i kompensoj investimet të cilat nuk i ka financuar, p.sh. grantet dhe asetet e dhuruara. Si pasojë e kësaj, amortizimi i aseteve të tilla nuk duhet të kalojë në tarifa. Në mënyrë tjetër, amortizimi mund të kalojë por edhe të balancohet duke trajtuar grantet (ose vlerën e aseteve të dhuruara) si të hyrat që amortizohen gjatë jetëgjatësisë së aseteve, rezultati i cili nuk është ekuivalent me moskalimin e amortizimit në tarifa.

WDPS 10: Trajtimi i granteve dhe aseteve të dhuruara

ZRRUM-i duhet t'i trajtojë asetet e siguruara nga grantet dhe asetet e dhuruara në mënyrë të ndryshme nga asetet e financuara përmes resurseve financiare të KLMC-së. ZRRUM-i duhet t'i aplikojë rregullat për amortizimin që në mënyrë të drejtë reflektojnë kapitalin e investuar.

3.4 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi

3.4.1 Struktura e kapitalit

Teoria ekonomike konvencionale tregon se struktura e kapitalit nuk ka kurfarë ndikimi në performancën e biznesit dhe si e tillë është çështje e menaxhimit të KLMC-së e jo çështje rregullatore. Kështu që kthimi në kapital (kur të zbatohet) duhet të bazohet në kthimin e vlerës totale të kapitalit të pavarur nga struktura kapitale. Derisa të lejohet kthimi në kapital, ZRRUM-i duhet t'i përfshijë obligimet e borxheve ekzistuese të KLMC-së (interesin dhe ri-pagimin e kryegjësë) në tarifa duke u bazuar në kërkesat e rrjedhjes së parasë të kompanisë.

WDPS 11: Struktura e kapitalit

Derisa ka mbulim të plotë të kostos, ZRRUM-i duhet të konsideroj strukturën kapitale në tarifën e shërbimeve në lidhje me financimin e borxheve ekzistuese dhe mbajtjen e rrjedhjes së parasë. Mirëpo, me arritjen e mbulimit të plotë të shpenzimeve, ZRRUM duhet ta ketë parasysh strukturën kapitale të KLMC-së si vetëm një çështje e menaxhimit të brendshëm dhe jo si një çështje rregullatore.

3.4.2 Vlera rregullatore e kapitalit

Vlera rregullatore e kapitalit (VRRK) definohet si vlera e aseteve mbi të cilën mund të arrihet kthimi (pasi që të arrihet mbulimi i plotë i kostos). Sipas parimeve rregullatore, KLMC-së nuk i takon të fitojë kthimin në asete të cilat ata nuk i financojnë, p.sh. grantet dhe asetet e dhuruara. Si pasojë e kësaj VRRK mund të jetë shumë e ndryshme nga vlera e regjistruar e aseteve. Fillimisht, VRRK duhet të vendoset nga ZRRUM-i dhe çfarëdo investime neto tjera të financuara nga KLMC-a duhet t'i shtohen VRRK dhe amortizimi duhet të përjashtohet nga VRRK (duke mos përfshirë amortizimin në grantet e financuara ose asetet e dhuruara (WDSP 10: Trajtimi i granteve dhe aseteve të dhuruara). Nëse qeveria heq dorë nga KLMC-a atëherë vlera fillestare e kapitalit gjatë kohës së lirimit do të lidhet me çmimin e paguar për biznesin dhe detyrimet afatgjate të huasë.

WDPS 12: Vlera rregullatore e kapitalit (VRRK)

ZRRUM-i duhet të vendos vlerën kapitale të bazuar në investimet të bëra nga resurset financiare të KLMC-së. Mirëpo, nëse qeveria heq dorë nga operimet atëherë për vlerën kapitale do të kërkohet një pikëpamje e ndryshme që reflekton vlerën e tarifës të aktivitetit dhe çfarëdo detyrime tjera afatgjate.

3.4.3 Kapitali i punës

Kërkesat e kapitalit të punës të KLMC-së do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e parasë të organizatave dhe si të tilla do të duhej të jenë të përfshira në tarifën e shërbimeve. Gjithashtu, me lejimin e kthimit në kapital që të kalojë përmes tarifave, vlera e kapitalit mbi të cilën mund të fitohet kthimi, duhet të përfshijë kërkesat e kapitalit të punës së KLMC-së.

WDPS 13: Kapitali i punës

Niveli i rrjedhjes së parasë për Ndërmarrjet Publike duhet të përfshijë çfarëdo ndryshime në kërkesat e kapitalit të punës. Me arritjen e mbulimit të plotë të kapitalit dhe përfshirjen e kthimit në kapital në tarifën e shërbimeve, kapitali i punës duhet të përfshihet në kapitalin total mbi të cilin mund të kryhet kthimi.

3.4.4 Kthimi i kapitalit

Derisa të arrihet mbulimi i plotë i kostos, koncepti për kthimin e drejtë në kapital është i tepërt. Ndërkohë, kthimi në kapital duhet të jetë i kufizuar vetëm në obligimet e shërbimit të huasë të rrjedhjes së parasë.

WDPS 14: Kthimi i kapitalit

Në kohën afatshkurte, kthimi në kapital duhet të jetë i kufizuar vetëm në kërkesat e rrjedhjes së parasë. Me lejimin e kthimit në kapital që të përfshihet në tarifa, niveli i kthimit duhet të vendoset në atë nivel i cili reflekton kategorinë e rrezikut të aktivitetit të deponimit të mbeturinave.

3.4.5 Procesi i vënies së taksave

Derisa KLMC-a nuk e nxjerr fitimin e tatueshëm, diskutimi për çështjen e vënies së tatimit mbi fitimin do të ishte i panevojshëm. Çfarëdo takse tjetër e 'pa-kompensueshme' duhet të reflektohet në tarifa kudo që duhet. Me lejimin e kthimit në kapital që të përfshihet në tarifa, kthimi në kapital duhet të bazohet mbi kthimin e 'post-taksës' me vlerën e taksës në kosto.

WDPS 15: Procesi i vënies së taksave

Taksat e 'pa kompensueshme' duhet të përfshihen në tarifa. Kur të përfshihet kthimi në kapital në tarifa atëherë duhet të përcaktohen mbi bazën e 'post-taksës'.

4. PROCESI

4.1 Shqyrtimet kryesore të tarifave

WDPS 16: Shqyrtimet kryesore të tarifave

Tarifat për vitin 2007/8 duhet të shqyrtohen çdo vit, në kohën ku politikat e tarifave mund të përpilohen me grup të kompletuar të rregullave që mund të mundësojnë periudha më të zgjatura në mes të shqyrtimeve.

4.2 Shqyrtimet e përkohshme

Në pajtim me Rregullorën 2004/49, neni 10.5, ZRRUM-i duhet t'i shqyrtoj tarifat çdo vit ose në kohë tjetër e cila caktohet në pajtueshmëri me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit me Shumicë..."ZRRUM-i duhet të vendos tarifa në mënyrë periodike me shqyrtim vjetor të kërkuar sipas rregullorës që kufizohet në rregullimin e inflacionit dhe rasteve të jashtëzakonshme.

WDPS 17: Shqyrtimet e përkohshme

ZRRUM-i duhet të bëjë shqyrtime të përkohshme periodike të tarifave duke marrë parasysh inflacionin dhe ndryshimet e jashtëzakonshme në mjedisin operativ.